

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,
SEZONI 2023/2024
(java e 51, deri më 24.12.2023)**

TË DHËNA JAVORE


Gjatë javës së 51 të vitit 2023 (nga 18.12-24.12.2023), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **205 (I=11,2/100.000)** të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 53,0% më shumë krahasuar me javën e kaluar (n=134).

Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=177) është regjistruar një rritje prej 15,8%, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit (n=155) është regjistruar një rritje prej 32,6%. (Grafiku 1)

Gjatë javës së 51-të të vitit 2023, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 34 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. 4 kanë rezultuar pozitive për Influenza, nga dy Influenza A(H1)pdm09 dhe Influenza A(H3). Janë regjistruar edhe 5 raste me virus sincial respirator (RSV).

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit (I=30,6/100.000), pra ende nuk është arritur pragu i hyrjes në sezonin e gripit (Grafiku 1).

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024




Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 117 persona, nga 0-4 vjet – 38, tek grupmosha nga 5-14 – 36 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 14 persona. Incidencë më e lartë (39,4/100.000) është regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Të sëmuret e kësaj jave janë raportuar nga 17 QShP/NjR: Dibër – 80, Gostivar-36, Tetovë – 26, Kumanovë – 19, ndërsa në qytetet e tjera numri i rasteve të raportuara është më pak se 10.

Në 15 njësi raportimi që kanë raportuar raste gjatë kësaj jave është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, ndërsa në 1 (Dibër) – aktivitet i lartë (*Hartogrami 1*).

Hartogrami 1. Niveli i aktivitetit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, jave e 51 2023



Gjatë kësaj jave është regjistruar një vdekje nga gripi. Bëhet fjalë për një person 71-vjeçar nga Shtipi i cili ka qenë i shtruar në SK në Shtip. Te i ndjeri është konstatuar prania e komorbiditeteve (kardiovaskulare dhe renale) dhe ai nuk ka qenë i vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Te i ndjeri është konfirmuar Influenza A(H1N1)pdm09.

MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - Të dhëna kumulative

Gjatë sezonit 2023/2024 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është **890 (I=48,5/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=583) numri i rasteve të regjistruara është rritur për për 52,7%%, ndërsa krahasuar me modelin e 13 viteve të fundit (n=853) është regjistruar një rritje prej 4,4%.

Raste janë raportuar nga gjithsej 20 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (432) dhe incidencë më e lartë kumulative (213,4/100.000) është regjistruar në Dibër.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 410 (46,1%), ndërsa incidencë më e lartë (213,4/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=206).

Shpërndarja e rasteve të gripit sipas muajve:

- tetor – 196 raste ose 22%
- nëntor – 268 raste ose 30,1%
- dhjetor – 426 raste ose 47,9%

Deri më tani gjatë këtij sezoni është regjistruar një rast i vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore) – Të dhëna kumulative

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e 51, pranë laboratorit të virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 357 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore.

Të gjitha materialet e pranuar janë testuar për prani të virusit të gripit dhe SARS-CoV-2, me ç'rast janë regjistruar pesë raste pozitive, 3 Influenza A(H1) dhe 2 Influenza A(H3), 4 raste pozitive me SARS-CoV-2. Janë regjistruar 18 raste me Virus Respirator Sincial (RSV).

MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së 51 janë raportuar gjithsej 48 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Klinika e sëmundjeve të fëmijëve ((n=18; 37,5%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=23; 47,9%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 220, me 2 raste të raportuara në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 21,8% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 44,4% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet. Gjatë kësaj ajve është raportuar një rast SARI me pasojë vdekjen, nga vendi sentinel në Shtip (SK Shtip).

Kumulativisht gjatë javës së 51 për analizë laboratorike kanë arritur 22 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit edhe për COVID-19 dhe 19 mostra për VSR. Në 2 nga mostrat e analizuara është vërtetuar prani e virusit të gripit AH1pdm09, në një mostër është vërtetuar COVID-19, ndërsa në 7 mostra virusi sincicial respirator.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 409 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (nga n=139; 34%) janë raportuar nga Instituti për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët KOZLE dhe Klinika e Sëmundjeve të Fëmijëve. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=228; 55,7%).


Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 2.310, nga të cilët 14 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 17,7% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 37,1% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Janë regjistruar edhe 2 raste të vdekjes të raportuara nga SK në Shtip, të grupmoshës mbi 65 vjet, pa komorbiditete, një pozitiv për COVID-19 dhe një për Influenza A(H1)pdm09.

Kumulativisht, për testim laboratorik janë dorëzuar 195 materiale nga rastet e raportuara SARI. Në një mostër u vërtetua Influenza B dhe në 4 Influenza AH1pdm09. Janë regjistruar 13 raste pozitive me COVID-19. Nga mostrat SARI, 168 u testuan për virusin respirator sincicial (RSV), nga të cilët 85 rezultuan pozitivë.

Adenovirusi u zbulua në 5 mostra dhe Enterovirus në një. Në 2 mostra është verëtuar prania e njëkohshme e virusit sincicial respirator (RSV) dhe adenovirusit.

Grafiku 2. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes të mostrave pozitive të gripit, R. e Maqedonisë së Veriut, 2023/2024



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vihet re një rritje e numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili është ende nën kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e marra nga mbikëqyrja virologjike e gripit nuk tregojnë aktivitet të virusit të influencës në 12 javë të mbikëqyrjes. Sipas këtyre të dhënave, Republika e Maqedonisë së Veriut ka intensitet të ulët dhe përhapje rajonale të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- ❖ Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- ❖ Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- ❖ Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- ❖ Gratë shtatzëna dhe
- ❖ Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për shëndetësi elektronike që nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti janë vaknuar gjithsej 58.235 persona nga kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale deri më tani janë vaksinuar gjithsej 2.276 persona.

Deri në javën e 51 në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 60.511 persona me vaksinat falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

- Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e 50 të vitit 2023 për aktivitetin e virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:
- Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksionet akute të frymëmarrjes (ARI) janë rritur mbi nivelet bazë në 17 nga 32 vendet dhe zonat e Rajonit Evropian të OBSH-së.
- Aktiviteti i gripit vazhdon të rritet dhe për herë të parë ka tejkaluar pragun sezonal prej 10%, aktiviteti i COVID-19 është rritur por mbetet stabil, ndërsa i RSV vazhdon të rritet.
- Pranimet në spital (SARI) me grip dhe RSV janë në nivele plato gjatë 4 javëve të fundit, ndërsa pranimet për COVID-19 janë stabile.
- Zbulimet e vërtetuara të infeksionit me virusin e influencës nga ISHP sentinel për javën e kaluar ishin Influenza Influenza A (97%) - A(H1)pdm09 (65%) dhe A(H3) (35%).
- Në të gjithë rajonin, nga mostrat e pacientëve nga mbikëyrja SARI:
- Shkalla e zbulimit të virusit të gripit është rritur në 14% krahasuar me 9% një javë më parë. Pozitiviteti mesatar varionte nga 0–32%
- SARS-CoV-2 është në 16% krahasuar me 19% javën e kaluar. Pozitiviteti mesatar i vendit ishte 6% (shtrirja: 0–30%).
- RSV u rrit në 21% krahasuar me 18% në javën e kaluar. Norma mesatare e pozitivitetit ishte 17% (shtrirja: 0-75%).

Nga 35 vendet që raportojnë për intensitetin e gripit, 1 vend ka raportuar për intensitet shumë të lartë, 2 të lartë, 11 kanë raportuar intensitet mesatar, 13 të ulët dhe 8 kanë raportua intensitet bazë.

Nga 35 vende që raportojnë për shpërndarjen gjeografike, 12 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë, 8 - rajonale, 10 - sporadike, 3 - lokale dhe pjesa tjetër kanë raportuar se nuk ka aktivitet të virusit të gripit.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik**